

20071061389

L I G J
PËR DETYRIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ME HUA TE BANKA
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM - BANKA BOTËRORE
SIPAS MARRËVESHJES PËR HUAN E DYTË PROGRAMORE PËR POLITIKA
ZHVILLIMORE – PDPL 2

Neni 1

Republika e Maqedonisë detyrohet te Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore me hua në shumë prej 23.300.000 euro, të dedikuara për realizimin e Huas së dytë programore për politika zhvillimore - PDPL 2.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit e huas nga neni 1 të këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen për hua të dytë programore për politika zhvillimore - PDPL 2, e cila lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 të këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar prej tij.

Neni 3

Afati i pagesës së huas nga neni 1 të këtij ligji është 17 vjet, me grejs periudhë të lidhur pesëvjeçare. Shkalla e kamatës sipas së cilës do të servisohet huaja është LIBOR (për valutë euro) plus interval fiks kohor. Shkalla e kamatës mund të jetë edhe më e vogël varësisht nga vendimet në fuqi të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Huaja do të paguhet në 24 këste gjysmëvjetore, në çdo 15 janar dhe 15 korrik të vitit. Nga 15 korriku 2012 deri në 15 korrik 2023 do të paguhet 23 këste gjysmëvjetore secili në shumë prej 4,17% nga huaja, gjegjësisht 971.610 euro, derisa më 15 janar 2024 do të paguhet kësti i fundit në shumë prej 4,09% nga huaja, gjegjësisht 971.610 euro.

Në grejs periudhën prej pesë vjetësh, që paraqet edhe periudhën e realizimit të projektit, do të paguhet vetëm kamata e huas.

Në ditën e tërheqjes së mjeteve, Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Botërore provizion të njëhershëm në shumë prej 1% nga shuma e huas, e cila mund të jetë edhe më e vogël varësisht nga vendimet në fuqi të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Në shumën e patërhequr të mjeteve nga huaja paguhet provizion i përcaktuar nga ana e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim në lartësi prej 0,75% në vit, e cila mund të jetë edhe më e vogël varësisht nga vendimet në fuqi të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Provizioni i mjeteve të patërhequra nga paragrafi 5 i këtij neni paguhet në çdo gjysmë viti, më 15 janar dhe më 15 korrik për çdo vit.

Neni 4

Shfrytëzues i mjeteve të huas nga neni 1 i këtij neni është Ministria e Financave në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Neni 5

Republika e Maqedonisë, huan nga neni 1 i këtij ligji do ta servisojë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".